

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 44-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuale**  
**mbajtur më 5.12.2022**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video konferencë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq, dr.Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë nëpërmjet lidhjes video konferencë ishte i pranishëm dhe dr.Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishëm nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video konferencë ishin:** mr.Dragica Ljubevska, Shqipe Tahiri, Maja Damevska, dr.Ivana Stojanovska.

**Të pranishmit e tjerë: /**

Z.Petrushevski hapi seancën e 44-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratimi i propozim-procesverbalit nga seanca e 43-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, e mbajtur më 28.11.2022.
2. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj SHTR TELEVIZIJA SHPK Kumanovë për shkelje të nenit 54 paragrafi (5) të LSHMAAV dhe nenit 4 të Rregullores për sponsorim.
3. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj SHTR TELEVIZIJA PLUS SHPK Kumanovë për shkelje të nenit 92 paragrafi (3) të LSHMAAV.
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj SHTR TELEVIZIJA PLUS SHPK Kumanovë për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Mediume.
5. Propozim për iniciimin e procedurës për kundërvajtje kundër Shoqërisë Tregtare për radio – me veprimtari radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 14 nga Ligji për Mediume.
6. Propozim për dhënien miratim për zbatim të procedurës për furnizim-kartolina për Vitin e Ri 2023 me vlerë të parashikuar nën pragun e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizime publike.
7. Të ndryshme.

**Pika 1**

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin nga seanca e 43-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 28.11.2022, me tekstin e propozuar.

#### **Pikat 2, 3 dhe 4**

Z.Petrushevski propozoi për Pikat 2, 3 dhe 4 drejtori ose shërbimi të bëjnë një hyrje të përbashkët, pasi që bëhet fjalë për të njëjtin medium që ka shkelur disa nene të Ligjit, që Këshilli të ketë një diskutim dhe votimi të kryhet për secilën shkelje në veçanti.

Anëtarët e Këshillit nuk kishin asnjë kundërshtim për këtë propozim.

Udhëheqësja e Njesisë për çështje programore dhe mbikëqyrje administrative Shqipe Tahiri i arsyetoi propozimet për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj SHTR TELEVIZIJA PLUS SHPK Kumanovë për shkelje të nenit 54 paragrafi (5), neni 92 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenit 14 të Ligjit për Mediume. Shpjegoi se nga mbikëqyrja e rregullt mbi shërbimin programor të radiodifuzerit u konstatua se më 5 tetor 2022 ishte transmetuar predikim fetar i sponsoruar-TV, që është në kundërshtim me nenin 54 paragrafi (5) të LSHMAAV, gjegjësisht TV PLUS ka publikuar telop (телоп) për „SN – Obroker Sigurimi A.D. Manastir“, të cilin e ka shënuar grafikisht dhe verbalisht si sponsor të emisionit me përmbajtje fetare. Në pajtim me Ligjin, propozohet shqiptimi i masës vërejtje publike. Ndërsa në lidhje me Pikën 3 , ajo shpjegoi se nga mbikëqyrja e rregullt programore u konstatua se më 10 tetor 2022, gjysma e programit të krijuar burimor nuk është transmetuar si vepra audiovizuele maqedonase në periudhën prej orës 7:00 deri në orën 19:00 , gjë që është në kundërshtim me nenin 92 paragrafi (3) të LSHMAAV. Gjithashtu, është konstatuar dhe shkelje e nenit 14 të Ligjit për Mediume, sepse më 5 tetor 2022, në pjesë të programeve të transmetuara, ai nuk ka publikuar të dhënat për impresium që është i detyruar t'i transmeton në vend të përshtatshëm për çdo përmbajtje në veçanti të shërbimit programor, pra është në kundërshtim me pikat 6 (impresium për programe të prodhimit vendor) dhe 10 (impresium për programe të prodhimit të huaj) të „Udhëzimeve për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacion në dispozicion të përdoruesve (shfrytëzuesve)“. Dhe për këto dy shkelje propozohet shqiptimi i masës vërejtje publike.

Gjatë prezantimit të pikave,udhëheqësja Tahiri ka pasur një problem teknik me lidhjen me konektimin video dhe audio.

Z. Trajçevski lidhur me tre shkeljet e TV Plus nga Kumanova shtoi se media ka dorëzuar deklaratë në të cilën ka thënë se mospërputhjet kanë ardhur për arsye teknike dhe gabime njerëzore dhe se tashmë kanë vepruar sipas udhëzimeve të ASHMA-së, dmth. i kanë mënjeluar (hequr) parregullsitë.

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit – Shef kabineti mr.Dragica Ljubevska, lidhur me shkeljen e nenit 14 të Ligjit për Mediume, shtoi se transmetuesi pas shqiptimit të masës vërejtje publike ka afat prej 45 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e Ligjit për Mediume.

#### **Votimi për pikën 2**

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, me nr.10-4076/1 datë 2.11.2022 dhe njëzëri vendosi që ndaj SHTR TELEVIZIJA PLUS SHPK Kumanovë t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 54 paragrafi

(5) të LSHMAAV dhe nenit 4 të Rregullores për sponzorim sepse më 5 tetor 2022, është transmetuar predikim TV- fetar i sponzoruar.

Në pajtim (përputhje) me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës me nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, urdhërohet që në afat brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Rregulloren për sponzorim.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të hartojë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për vërejtje publike, të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk vepron).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, duhet ta publikojë Aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

### Votimi për pikën 3

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, me nr.10-4068/1 datë 2.11.2022 dhe njëzëri konstatoi se ndaj SHTR TELEVIZIJA PLUS SHPK Kumanovë t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 92 paragrafi (3) të LSHMAAV sepse më 10 tetor 2022, nuk ka transmetuar gjysmën e programit të krijuar burimor si vepra audiovizuele meqendonase në periudhër nga ora 7:00 deri në ora 19:00.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës me nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, urdhërohet që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të hartojë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk vepron).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, duhet të publikojë Aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

### Votimi sipas pikës 4

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative, me nr.10-4090/1 datë 2.11.2022 dhe njëzëri konstatoi se ndaj SHTR TELEVIZIJA PLUS SHPK Kumanovë t'i shqiptoi masë vërejtje publike për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Medime, sepse më 5 tetor 2022, në disa prej programeve të transmetuara, nuk ka publikuar të dhënat për impresium që është i detyruar t'i transmeton në vendin e përshtatshëm (duhur) për çdo përmbajtje në veçanti të shërbimit programor.

Në pajtim me pikën 7 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës me nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, urdhërohet që në afat prej 45 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e Ligjit për Mediume.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të hartojë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, duhet ta publikojë aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

## **Pika 5**

Z. Trajçevski shpjegoi propozimin për ngritjen e procedurës për kundërvajtje kundër Shoqërisë Tregtare me veprimtari radio-difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Mediume. Ai ka shpjeguar se këtij transmetuesi paraprakisht i është shqiptuar masë vërejtje publike për shkeljen në fjalë, për të cilën kishte afat prej 45 ditësh për t'i mënjanuar (eliminuar) parregullsitë. Pas skadimit të afatit, është kryer mbikëqyrje kontrolli dhe sërish është konstatuar se një numër i madh emisionesh janë transmetuar pa impresium, pra pa të dhënat që transmetuesi është i detyruar t'i transmeton në vendin e përshtatshëm (duhur) për çdo përmbajtje të shërbimit programor. Për këtë arsye propozohet që ndaj TV Shutell të inicohet procedurë për kundërvajtje para gjykatës kompetente.

Udhëheqësja Tahiri ka sqaruar se pas shqiptimit të masës vërejtje publike është deklaruar me shkrim se do të korrigojohet, po ashtu dhe Spektori ka mbajtur një takim pune me personin përgjegjës në ambientet e Agjencisë, ku i është shpjeguar se si duhet të respektojë Ligjin, në mënyrë që në të ardhmen shkelja të mos përsëritet dhe nga ana e tij u pranua gjithçka. Lidhur me këtë, ai tha se tani nuk e di pse janë bërë sërish të njëjtat gabime.

Z. Fidanoski, në lidhje me plotësimin nga ana e udhëheqëses Tahiri, tha se Agjencia ka bërë të pamundurën për t'i ndihmuar transmetuesit dhe për të mënjanuar mospërputhjet me Ligjin, por është e qartë se mediumi këtë nuk e ka zbatuar, se pse nuk dihet.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të kontrollit administrativ me nr.10-4083/1 datë 2.11.2022 të Shoqërisë Tregtare për veprimtari radio-difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup dhe konstatoi shkelje të nenit 14 të Ligjit për Mediume.

Këshilli njëzëri konkludoi kundër Shoqërisë Tregtare për veprimtari radio – difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup t'i inicojë procedurë për kundërvajtje para gjykatës kompetente sepse me mbikëqyrjen e kontrollit u konstatuase se më 13 tetor 2022, në pjesë të programeve të transmetuara nuk ka publikuar të dhënat për impresium që detyrohet t'i transmeton në vendin e përshtatshëm (duhur) për çdo përmbajtje në veçanti të shërbimit programor.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Kërkesën për fillimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente për transmetuesin në fjalë.

## **Pika 6**

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit – Shef kabineti mr.Dragica Ljubevska ka shpjeguar Propozimin për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për furnizimin ose blerjen e kartolinave për Vitin e Ri me vlerë të parashikuar nën pragun e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizime publike. Ajo shpjegoi se objek i furnizimit janë kartolinat për Vitin e Ri dhe për të dorëzuar ofertat , ku Agjencia i është drejtuar SOS Detsko Sello, Lice v lice dhe Ambasada e Parë e Fëmijëve në botë, Megjashi. Sipas ofertave të dorëzuara, financiarisht më e favorshme dhe më e pranueshme për Agjencinë është oferta e SOS Detsko Sello, e cila nuk do ta kalojë shumën prej 8.000,00 denarë pa TVSH për shkak se nuk është tatimpagues.Për të mundësuar blerjen e sasisë së nevojshme të kartolinave për Vitin e Ri, nga Këshilli kërkohet miratimi i Vendimit për blerjen e kartolinave.

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele miratoi njëzëri vendimin për blerjen (furnizimin) e kartolinave për Vitin e Ri për nevojat e Agjencisë, me vlerë të caktuar nën pragun e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik, që nuk e kalon shumën prej 8.000,00 denarë pa TVSH e llogaritur.

Për realizimin e shërbimit të mësipërm, fondet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2022.

#### **Pika 7**

#### **Të ndryshme**

Nuk ka pasur asnjë diskutim nën Të ndryshme.

**Nr.02-4482/7**

**22.12.2022**

**Shkup**

**Agjencia për Shërbime  
Mediatike Audio dhe Audiovizuele  
Kryetar i Këshillit**

---

**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**